


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6136
E hënë, 12 tetor 2020
çmimi 0.40 €

PDK-ja: Mungesa e investimeve në çerdhe dhe shkolla rëndoi jetën e prindërve në Prishtinë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI KA THËNË TË DIELËN SE RREZIKU NGA NJË VALË E RE E COVID-19 NË KOSOVË ËSHTË SHUMË I MADH | FAQE 3

QEVERIA PARALAJMËRON SHTRËNGIM TË MASAVE NDAJ COVID-19



Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka thënë se në dy javët e fundit numri i të prekurve me Covid-19 ka qenë në rënje, me rreth 30 raste aktive për çdo 100 mijë banorë. Por, sipas tij, parashikimet janë se ky numër shpejt mund ta kalojë shifrën prej 50 dhe atëherë, sipas protokolleve, duhen shtrënguar masat siç po ndodh në shumicën e

vendeve të BE-së. "Të gjithë duhet të kemi mirëkuptim për shtrëngimin e masave në javët në vijim, që përfshijnë ndërprerje të tubimeve të mbyllura, kufizime të çdo aktiviteti ku mbliidhen qytetarë, kontroll rigoroz i shkollave për përmbushje të masave për mbrojtjen nga Covid-19 dhe masa të tjera", ka deklaruar kryeministri Hoti

AKTUALE



TRUMPI MBAN NGJARJEN E PARË PUBLIKE QË PREJ SE U INFEKTUA ME COVID-19 | F. 2

AVOKATI BERISHA: NË GJYKATË DORËZUAM PROVA PËR PAFAJËSINË E HAKI RUGOVËS | F. 7

LAJÇAKU KËRKON NGA KOSOVA TA ZBATOJË MARRËVESHJEN PËR ASOCIACIONIN | F. 5

EKONOMI



LUFTA POLITIKE PO 'VRET' BIZNESET | F. 8

RRETH 90 PËR QIND E INVESTIMEVE TË HUAJA NË KOSOVË SHKOJNË NË BLERJEN E BANESAVE | F. 8

SPORT

HAXHI ROBIN KRASNIQI, KAMPION I BOTËS NË IBO DHE WBA | F. 14



MALIQI: TË HAPET NJË GJYKATË E HAGËS PËR KRIMET E PADËNUARA TË SERBISË



Analisti Shkëlzen Maliqi ka thënë se duhet të iniciohet një peticion në Kosovë dhe një peticion ndërkombëtar në të cilët kërkohet përgjegjësi dhe ndjekje penale e të gjithë zyrtarëve serbë për aferën makabre të varrezave masive të fshehura me vite.

Ai, po ashtu, ka kërkuar që të hapet edhe një gjykatë e Hagës për krimet makabre të padënuara të Serbisë. Ndërkaq përfaqësues të skenës politike në vend kanë theksuar se mosdënimi i gjenocidit të Serbisë është përgjegjësi e politikës së vendeve euroatlantike | FAQE 4-5

VETËVENDOSJA E THËRRET HOTIN NË TRI INTERPELANCA: PËR UJMANIN, TË PAGJETURIT DHE ASOCIACIONIN | FAQE 6



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A.
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Në Serbi bëhen stërvitje me dronë kinezë dhe avionë rusë

BEOGRAD, 11 TETOR - Avionë, helikopterë dhe tanke të prodhimit rus zhvilluan qitje të shtunën në Pester, një zonë e vetmuar stërvitjesh në Serbinë perëndi-

more, ndërsa në qiell fluturonin dronët ushtarakë kinezë. Manovrat e quajtura "Bashkëpunimi 2020" ishin demonstrim i një fuqie ushtarake të ripërtëritur të

Serbisë dhe u ndoqën nga presidenti Aleksandër Vuçiq dhe personalitete të tjera. Gjatë stërvitjeve u nënvizuan lidhjet e ngushta ushtarake të Serbisë me

Pekinin dhe Moskën. Vitet e fundit, Beogradi ka përshpejtuar shpenzimet e mbrojtjes, ndërkohë që kërkon dominim në Ballkanin Perëndimor.



Trumpi mban ngjarjen e parë publike që prej se u infektua me Covid-19

UASHINGTON, 11 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka mbajtur ngjarjen e parë publike që prej se është infektuar me Covid-19 dhe u ka thënë mbështetësve të vet në Shtëpinë e Bardhë, se po ndihet "shumë mirë". Trumpi foli me dhjetëra-qindra mbështetës, kryesisht hispanikë dhe afrikano-amerikanë nga një ballkon në Shtëpinë e Bardhë më 10 tetor, një ngjarje që u quajt "protestë paqësore për rendin dhe ligjin", por që kishte të gjitha tiparet e një tubimi zgjedhor.

Presidenti, i cili nuk po bartte maskë fytyre, mbajti një fjalim të shkurtër, duke sulmuar rivalin e tij demokrat, Joe Biden dhe duke vlerësuar punën e forcave të rendit dhe duke përmendur arritjet e administratës së tij. Mbështetësit e tij, që morën pjesë në këtë ngjarje, mbanin maska, por nuk kishte distancë fizike mes tyre.

Trumpi, po ashtu, deklaroi se pandemia po "zhdukej" edhe pse ai dhe dhjetëra zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë janë infektuar me koronavirus.

Mbi 213 mijë amerikanë kanë vdekur nga Covid-19, sëmundja



që e shkakton koronavirusi. "Ne po prodhojmë terapi të fuqishme dhe hapa. Ne po i shërojmë të sëmurët dhe ne do të shërohemi si dhe vaksina do të vijë shumë shpejt, në një kohë rekorde", ka

thënë Trumpi. Presidenti Trump mezi po pret që t'iu rikthehet tubimeve zgjedhore për zgjedhjet e 3 nëntorit ku, sipas sondazheve, kundërkandidati i tij demokrat, Joe Biden, po udhëheq

me dhjetë pikë. Bideni, mbështetësit e të cilit mbajnë maska dhe respektojnë distancën fizike në tubimet zgjedhore, e ka cilësuar Trumpin si "të papërgjegjshëm" për

mbajtjen e tubimeve zgjedhore. I pyetur për këtë gjë teksa po qëndronte në Delauer, Bideni tha se shpreson që Trumpi dhe mbështetësit e tij po marrin masat e duhura mbrojtëse.

Administrata e Trumpit po përballet me kritika për mënyrën e menaxhimit të pandemisë, por edhe për qasjen e tyre ndaj mbajtjes së maskave dhe distancës fizike në Shtëpinë e Bardhë.

Më 10 tetor doktori i Trumpit tha se presidenti më nuk ka rrezik që ta transmetojë virusin. Testet që i janë kryer presidentit, sipas doktorit Sean Conley, nuk kanë treguar "të dhëna se virusi po shumohet në mënyrë aktive".

Kritikët e kanë akuzuar doktorin e presidentit se ai nuk po është transparent me publikun sa i përket gjendjes shëndetësore të presidentit.

Sipas Qendrave për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, një person i infektuar me koronavirus duhet të presë të paktën dhjetë ditë, që nga shfaqja e parë e simptomave që ta përfundojë karantinën. Sipas doktorëve të Trumpit, presidenti ka pasur simptomat e para të Covid-19 më 1 tetor.

Në Serbi bëhen stërvitje me dronë kinezë dhe avionë rusë

BEOGRAD, 11 TETOR - Avionë, helikopterë dhe tanke të prodhimit rus zhvilluan qitje të shtunën në Pester, një zonë e vetmuar stërvitjesh në Serbinë perëndimore, ndërsa në qiell fluturonin dronët ushtarakë

kinezë. Manovrat e quajtura "Bashkëpunimi 2020" ishin demonstrim i një fuqie ushtarake të ripërtëritur të Serbisë dhe u ndoqën nga presidenti Aleksandër Vuçiq dhe personalitete të tjera. Gjatë

stërvitjeve u nënvizuan lidhjet e ngushta ushtarake të Serbisë me Pekinin dhe Moskën. Vitet e fundit, Beogradi ka përshpejtuar shpenzimet e mbrojtjes, ndërkohë që kërkon dominim në Ballkanin Perëndimor.



Koreja e Veriut demonstroi një raketë të re

PENIAN, 11 TETOR- Koreja e Veriut ka demonstruar gjatë një parade ushtarake një raketë të re balistike ndërkontinentale. Analistët thanë se raketa, e cila u shfaq në një automjet trans-

porti me 11 boshte, është një nga më të mëdhatë në botë në kategorinë e raketave ndërkontinentale të lëvizshme, nëse vihet në përdorim. Është hera e parë që Koreja e Veriut paraqet

raketa balistike qëkur udhëheqësi i saj filloi takimet me udhëheqësit ndërkombëtarë, duke përfshirë presidentin e SHBA-së, Donald Trump, në vitin 2018.

Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë të dielën se rreziku nga një valë e re e Covid-19 në Kosovë është shumë i madh

Qeveria paralajmëron shtrëngim të masave ndaj Covid-19

Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka thënë se në dy javët e fundit numri i të prekurve me Covid-19 ka qenë në rënie, me rreth 30 raste aktive për çdo 100 mijë banorë. Por, sipas tij, parashikimet janë se ky numër shpejt mund ta kalojë shifrën prej 50 dhe atëherë, sipas protokolleve, duhen shtrënguar masat siç po ndodh në shumicën e vendeve të BE-së. “Të gjithë duhet të kemi mirëkuptim për shtrëngimin e masave në javët në vijim, që përfshijnë ndërprerje të tubimeve të mbyllura, kufizime të çdo aktiviteti ku mblidhen qytetarë, kontroll rigoroz i shkollave për përmbushje të masave për mbrojtjen nga Covid-19 dhe masa të tjera”, ka deklaruar kryeministri Hoti



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 TETOR - Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë të dielën se në dy javët e fundit numri i të prekurve me Covid-19 ka qenë në rënie, me rreth 30 raste aktive për çdo 100 mijë banorë. Por, parashikimet, sipas tij, janë se ky numër shpejt mund ta kalojë shifrën prej 50 dhe atëherë, sipas protokolleve, duhen shtrënguar masat, siç po ndodh në shumicën e vendeve të BE-së. “Brenda javës së fundit është shtuar për 30 përqind numri i hospitalizimeve. Në anën tjetër, nxënësit që kanë rezultuar pozitivë me Covid-19 si përqindje e numrit të nxënësve të testuar është i lartë, që është rrezik serioz i përhapjes së virusit. Prandaj, të gjithë duhet të kemi mirëkuptim për shtrëngimin e masave në javët në vijim, që përfshijnë ndërprerje të tubimeve të mbyllura, kufizime të çdo aktiviteti ku mblidhen qytetarë, kontroll rigoroz i shkollave për përmbushje të masave për mbrojtjen nga Covid-19 dhe masa të tjera”, ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në “Facebook”. Ai ka thënë se inspektoratet dhe institucionet e tjera mbështetëse, qendrore dhe lokale, do t’i përgatisin planet e tyre të veprimtimit për ta mbikëqyrë zbatimin e masave.

1 197 raste aktive me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në vendin tonë kanë vdekur dy persona nga Covid-19, duke e çuar në 647 numrin e përgjithshëm të të vdekurve. Po ashtu, ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 53 persona dhe janë paraqitur

49 raste të reja, ku Prishtina vazhdon të prijë me numrin më të madh të të infektuarve nga Covidi. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 680 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 49 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast Spitali i Përgjithshëm Gjakovë dhe 1 rast Spitali i Përgjithshëm Pejë). Numri total i rasteve pozitive është 16 179 raste nga 74 586 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 647 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 53 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 335 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 197”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve nga secila komunë. “Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 27 raste, komuna

Gjilan 7 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Viti 4 raste, komuna Kaçanik 2 raste dhe me nga një rast komunat Gjakovë, Lipjan, Skenderaj, Graçanicë dhe Vushtrri. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën”, ka njoftuar IKShPK-ja.

Zemaj falënderon qytetarët për disiplinën e treguar për respektimin e masave anti-Covid

Duke iu referuar gjendjes aktuale me Covid në Kosovë, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka falënderuar qytetarët për disiplinën që kanë treguar kohën e fundit sa i takon respektimit të masave anti-Covid. “Ju jam falënderues që asnjëherë nuk u lodhët duke na qëndruar në krahë për të ardhur këtu ku jemi. Falë juve sot ne mund të krenohemi që jemi në shtatë vendet me menaxhimin më të mirë ndaj Covid-19 dhe duke besuar thellë në ju, jam i bindur se do

t’ia dalim mbarë dhe ta mposhtim këtë virus. I vetëdijshëm se ndonjëherë kemi mundur të jemi edhe të mërziqshëm duke e përsëritur kërkesën për respektimin e masave anti-Covid, ju falënderoj për durimin”, ka thënë Zemaj, duke shtuar se, krahas luftimit të pandemisë, nuk kanë lënë anash as obligimet e tjera për sistemin shëndetësor. “Sjellja e rregulloreve, vendimeve dhe udhëzimeve kundër virusit, do ta përcjellë me zbatimin e tyre, ndryshe përkushtimi i tërësishëm institucional e qytetar nuk do të japë rezultatet e pritshme, fitoren e plotë. Përtej menaxhimit të pandemisë dhe fokusit të luftimit të virusit Covid-19, bashkë me ekipin tim, profesionistët shëndetësorë dhe bashkëpunëtorët, asnjëherë nuk i kam lënë anash edhe obligimet e tjera për sistemin shëndetësor. Qytetari i Republikës së Kosovës çdoherë dhe në çdo kohë ka nevojë për shërbime të mira shëndetësore, meriton sigurime shëndetësore, vaksina sezonale, por edhe për ato kundër Covid-19, më shumë kontrolle me mamografi dhe rregull nëpër klinika, QKMF dhe spitale, barna e kushte në sallat e operacionit, pengimin e infeksioneve dhe kohë sa më të shkurtër të pritjes për operacion apo kontroll specialistik”, ka thënë Zemaj. Më tutje, ai ka folur edhe për trajtimin jashtë vendi të qytetarëve të Kosovës. “E di se brengoseni kur merrni rrugë jashtë vendit për trajtim, brengë për mjekët që largohen dhe infermierët që mësojnë gjuhë të huaja për të shkruar diku, për agresivitetin kundër stafit mjekësor, për fyerjet që i bëjnë personat me qëllim të njollosjes së punës së mjekëve. E di, nuk është e lehtë. Megjithatë, sivjet sistemit

publik shëndetësor iu kanë shtuar 1 500 specializantë. Po bëjmë gjithçka që të krijojmë kushte të mos ikin mjekët tanë jashtë vendit dhe të ofrojmë mundësi për të gjithë mjekët specialistë që duan të jenë brenda institucioneve publike shëndetësore. E kuptoj brengën tuaj, shumë prej jush edhe keni të drejtë për ato çfarë thoni, por vizioni i qartë dhe përkushtimi im janë tiparet që e cilësojnë punën time”, është shprehur Zemaj, duke shtuar se rregullimin e shëndetësisë publike ua kanë borxh edhe dëshmorëve të kombit. “Të nderuar qytetarë, punën e ndershme, me përkushtim ndaj shëndetit publik dhe rregullimit të sistemit shëndetësor, ua kemi borxh dëshmorëve që ranë për këtë vend, kontribuuesve për liri dhe çlirim, prindërve, motrave e vëllezërve tanë, por edhe fëmijëve që duam t’i rrisim këtu me shëndetësi të përparuar dhe mirëqenie shëndetësore. Para disa ditëve, me kërkesën time, kam raportuar në Komisionin për Shëndetësi dhe çdoherë do të jem i gatshëm të raportoj para ligjvënësve në çfarëdo formati sepse duke qenë transparent dhe llogaridhënës, kemi mundësi t’i shohim punët që kemi bërë dhe ato që na presin. Kjo është një sfidë e madhe që na takon të gjithëve, para së gjithash ne hartuesve dhe zbatuesve të politikave, andaj edhe nëpërmjet kësaj letre drejtuar juve qytetarë të nderuar, u bëj thirrje ish-ministrave të shëndetësisë, por edhe opozitës, që në një formë apo tjetër të jenë bashkëveprues me ne, ta përmirësojmë shëndetësinë e Kosovës”, ka thënë Zemaj. Në fund Zemaj ka falënderuar donatorët dhe shtetet mike të cilat kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për luftimin e pandemisë dhe avancimin e shëndetësisë.

Dasmat mund të bëhen burim i përhapjes së Covidit

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se rikthimi i tubimeve të qytetarëve, duke përfshirë edhe dasmat tradicionale, lëndon rëndë disiplinën dhe rekomandimet për pengimin dhe luftimin e virusit Covid-19. “Dasmat mund të bëhen burim i infeksionit dhe kjo është e palejueshme. Tri dasma janë ndërprerje dhe janë marrë masa edhe ndaj pronarëve të objekteve ku janë mbajtur ato, në Gjakovë, Junik dhe Sllatinë. Ndërsa në lagjen Arbëria në Prishtinë është

mbyllur një lokal nate dhe, po ashtu, janë marrë masa edhe ndaj pronarëve të këtij lokali. Prioritet yni mbetet shëndeti i qytetarëve, për këtë kemi sjell rregullore të cilat e mbrojnë shëndetin e qytetarëve. Kushdo që bie ndesh me ligjin, do të ketë pasoja. Dasmat dhe çdo tubim tjetër që mund të jetë burim i virusit Covid 19 do të pengohet dhe mbyllet në pajtim me rregulloren për pengimin dhe luftimin e virusit. Ligji është shumë i qartë, duhet vetëm të zbatohet!”, ka thënë Zemaj.



Edhe pas dy dekadash nga koha kur në Kosovë shteti serb kreu gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës, drejtësia nuk ka ngadhënjyer

MALIQI: TË HAPET NJË GJYKATË E HAGËS PËR KRIMET E PADËNUARA TË SERBISË

Analisti Shkëlzen Maliqi ka thënë se duhet të iniciohet një peticion në Kosovë dhe një peticion ndërkombëtar në të cilët kërkohet përgjegjësi dhe ndjekje penale e të gjithë zyrtarëve serbë për aferën makabre të varrezave masive të fshehura me vite. Ai, po ashtu, ka kërkuar që të hapet edhe një gjykatë e Hagës për krimet makabre të padënuara të Serbisë. Ndërkaq përfaqësues të skenës politike në vend kanë theksuar se mosdënimi i gjenocidit të Serbisë është përgjegjësi e politikës së vendeve euroatlantike

Milloseviqit, por edhe të gjitha regjimet pasuese. Le të hapet edhe një Gjykatë e Hagës për krimet makabre të padënuara të Serbisë zyrtare”, ka shkruar publicisti Maliqi.

Politologu Bardhyl Mahmuti ka thënë se edhe pas dy dekadash nga koha kur në Kosovë shteti serb kreu gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës, drejtësia nuk ka ngadhënjyer. Ai ka thënë se një tribunal për krimet serbe në Kosovë mund të realizohet përmes shtimit të amendamenteve në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. “Mbi dhjetë mijë familje të 1 392 fëmijëve të vrarë, të 1 739 grave të vrara dhe mijëra civilëve të tjerë të të

gjitha moshave që u vranë gjatë luftës në Kosovë presin drejtësi. Mbi njëzet mijë gra shqiptare ndaj të cilave u përdor dhunua seksuale presin drejtësi. Mbi 1 600 familje shqiptare, të cilët ende nuk dinë për fatin e më të dashurve të tyre, presin drejtësi. Lista e krimeve të pandëshkuara të shtetit serb gjatë luftës në Kosovë është shumë e gjatë. Këto fakte e bëjnë legjitime iniciativën për krijimin e një gjykate që do t'i ndëshkonte krimet të cilat nuk vjetërsohen asnjëherë. Mirëpo, për të krijuar një gjykatë ndërkombëtare që do ta ndiqte zinxhirin komandues dhe kriminelët që kryen gjenocid në Kosovë, duhet që OKB-ja të sjellë vendim për këtë gjë. Fatkeqësisht, në Këshillin e

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 TETOR - Analisti Shkëlzen Maliqi ka kërkuar që Serbia të detyrohet t'i zbulojë 16 varrezat masive të krimeve të luftës që në një emision televiziv i përmendin zyrtarët e kabinetit të ish-kryeministrit serb Zoran Gjingjiq. Ai, po

ashtu, ka kërkuar që të hapet edhe një gjykatë e Hagës për krimet makabre të padënuara të Serbisë. “Kryediplomati dhe ish-kryeministri serb Ivica Daçiq të ndiqet penalisht për obstrukcion të drejtësisë në zbulimin e krimeve masive të luftës. Prokuroria e Kosovës ta ngrehë padinë! Të iniciohet peticioni në Kosovë dhe

peticion ndërkombëtar ku kërkohet përgjegjësia dhe ndjekja penale e të gjithë zyrtarëve serbë për aferën makabre të varrezave masive të fshehura me vite”, ka shkruar Maliqi në llogarinë e vet në “Facebook”. “E kemi ditur këtë edhe më herët, por tani kemi dëshmitë e dorës së parë që akuzojnë jo vetëm regjimin e

18 në Novolan të Vushtrrisë. 81 motra e vëllezër tanë që, pasi u ekzekutuan, u mohuan nga varrimi dinjitoz dhe u shëtitën nëpër vendvarrime të ndryshme”, ka thënë ai.

Ai ka shtruar disa pyetje në lidhje me këto krime që ka bërë Serbia. “Pse ndodhi kjo bartje? Pse të lëvizen mbetjet mortore nga një vend në tjetrin? Çfarë fsheh Serbia? Pse ishin kaq mizorë me të gjallët, por edhe me të vdekurit tanë? Janë shumë ‘pse’-ja?”, ka shkruar deputeti Gazmend Syla.

Ai ka bërë me dije se për shkak të pamjeve të tmerrshme, është i detyruar që të mos i publikojë të gjitha faqet e dokumenteve. “Sot po ndaj me ju disa nga dokumentet që, në fakt, janë ‘raporte të vëzhgimit tekniko-kriminalistik të vendit të ngjarjes’ të kryera nga organet e Ministrisë së Brendshme të Serbisë, pak para largimit të tyre nga Kosova”, ka shkruar Syla.

Kurse ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka vizituar të dielën fshatin Lybeniq të Pejës ku forcat paramilitare serbe kryen masakër në këtë fshat. Aty më 25 maj 1998 forcat serbe hynë në fshatin Lybeniq të Pejës, duke vrarë e masakruar nëntë banorë të Lybeniqit, më vonë edhe burrat e tjerë të fshatit, në mesin e tyre edhe Muhamet Ukshinaj i cili ishte vetëm dyvjeçar. “Sot në Lybeniq, ku dhimbja është e gjallë. Muhamet Ukshinaj ishte vetëm dyvjeçar!”, ka shkruar në llogarinë e vet në “Facebook”, ish-kryeministri Haradinaj.

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, më herët kishte thënë për gazetën “Epoka e re” se mosdënimi i gjenocidit të Serbisë është përgjegjësi e politikës së vendeve euroatlantike. “Serbia para disa vitesh është dashur të dënohej për politikën e gjenocidit që i ka udhëhequr në Kosovë, Bosnje e Hercegovinë dhe Kroaci. Deklaratat e fundit të Vuçiqit, por edhe të zyrtarëve të tjerë serbë, janë dëshmi se ata nuk kanë hequr dorë nga ato politika, bile në disa raste vetëm se janë trimëruar, siç është rasti me Gjykatën Speciale të Kosovës me seli në Hagë. Mosdënimi i gjenocidit të Serbisë ishte dhe është përgjegjësi e politikës së vendeve euroatlantike”, ka thënë Krasniqi.

Ai kishte thënë se lufta çlirimtare e asnjë kombi nuk mund të dëmtohet. “Pse po vendoset një standard në ‘drejtësi’ që nuk ka asnjë lidhje të vetme me drejtësinë e vendosur si vlerë nga komuniteti ndërkombëtar. Me cilin standard të njohur ndërkombëtar përndiqen çlirimtarët e jo kriminelët që mbollën, kultivuan dhe ekzekutuan për vite gjenocidin? Këto janë politika absurde, që mendja e urtë e njeriut nuk mund t’i pranojë”, kishte deklaruar Krasniqi.

LAJÇAKU KËRKON NGA KOSOVA TA ZBATOJË MARRËVESHJEN PËR ASOCIACIONIN

PRISHTINË, 11 TETOR - Emisari special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka kërkuar nga Kosova që ta zbatojë marrëveshjen për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Në një intervistë për “Vienerzeitung”, ai ka theksuar se pala e Kosovës vetë e ka nënshkruar marrëveshjen dhe se kjo tani duhet të implementohet. “Tjetër sfidë është marrëveshja për asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Palët ishin pajtuar për këtë më 2013/2015, por s’është implementuar kurrë. Është çështje e ndjeshme në të cilën ka dhënë fjalën e saj edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe ky opinion duhet të merret parasysh. Por

ata që kundërshtojnë se tash nuk është koha e duhur, i pyes: ‘Kur, nëse jo tash? Ju e keni nënshkruar këtë marrëveshje vetë’”, ka thënë ai.

Lajçak ka thënë se qëllimi i Bashkimit Evropian është një marrëveshje që rregullon të gjitha çështjet e hapura dhe të paadresuara në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Me aprovimin më 2013/2015 vjen edhe obligimi për ta implementuar. S’ka çështje që negociohet e që është e lehtë, por nëse e ndërpresim dialogun sërish, do të na duhet ta rinisim”, ka deklaruar Lajçak.

Rreth kësaj teme ka reaguar anëtarja e kryesisë në Lëvizjen Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, e cila ka thënë se vetëm qeverisë së

kësaj lëvizjeje nuk mund t’ia kërkojnë themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Sipas saj, kryeministri Avdullah Hoti është tejet i përshtatshëm për t’i bërë trysni për asociacionin pasi është asistent i Isa Mustafës, nënshkruarit të “Zajednicës” më 25 gusht 2015. “Vetëm qeverisë së LV-së nuk mund t’ia kërkojnë asociacionin, meqenëse ne e kemi kundërshtuar edhe në vitin 2013, por edhe në vitin 2015. Hoti është tejet i përshtatshëm për t’i bërë trysni pasi që është asistent i Isa Mustafës, nënshkruarit të ‘Zajednicës’ më 25 gusht 2015, në dokumentin ku kërkohej vetëm parafimi”, ka shkruar Haxhiu në llogarinë e vet në “Facebook”.

Sigurimit të OKB-së ka shtete që do të përdornin të drejtën e vetos për ta bllokuar çdo iniciativë që ndëshkon Serbinë. Për këtë arsye e vetmja rrugë që të jemi sa më efikas në këtë çështje mbetet të shqyrtohet mundësia e amendamenteve në Ligjin Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Shtimi i amendamenteve që do ta hapte rrugën e krijimit të dhomave të veçanta për të gjitha krimet e kryera nga Serbia gjatë luftës në Kosovë është rruga më e sigurt dhe me më pak pengesa për realizimin e tribunalit për krimet gjatë luftës në Kosovë”, ka thënë ai.

Të dielën edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Gazmend Syla, në llogarinë e vet në “Facebook” ka publikuar dokumente që dëshmojnë krimet serbe në Kosovë. Deputeti Syla ka përmendur krimet në Suharekë, Suhodoll të Mitrovicës, Brusnik dhe Novolan të Vushtrrisë. “Kufoma të ekskumuara, që iu ndryshohet vendi i varrimit dhe, sipas gjasave, për çështje kohe, nuk kanë pasur mundësi t’i transportojnë në Batajnicë apo vendvarrime të tjera. 18 kufoma në Suharekë, 25 në Suhodoll të Mitrovicës, 20 në Brusnik dhe



Lugina e Preshevës duhet të jetë temë në dialogun për marrëveshjen përmbyllëse Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 11 TETOR - Qytetarët e Luginës së Preshevës po kërkojnë që çështja e tyre të përfshihet në marrëveshjen përfundimtare në mes të Kosovës e Serbisë, gjë të cilën e kanë shprehur përmes kërkesave, platformave dhe deklaratave të tyre politike ndër vite. “Përfshirja e Luginës së Preshevës në marrëveshjen përfundimtare është garanci për paqe”, ka thënë për “Telegrafi” kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar, Ragmi Mustafa, i cili ka folur edhe për marrëveshjen e arritur së fundmi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. “Pas

mungesës së çështjes së Luginës së Preshevës në Rambuje, në Vjenë dhe në dialogun ‘teknik’ të Brukselit, nuk ka dyshim se Lugina duhet të jetë temë e trajtuar në dialogun për marrëveshjen e mundshme përmbyllëse midis Kosovës dhe Serbisë, në përputhje me vullnetin politik të shprehur nga shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe me kërkesat e të zgjedhurve të tyre të shprehura në platformat e deklaratat e tyre politike, që nga referendumi i vitit 1992 e deri në Deklaratën Politike të vitit 2018”, ka thënë Mustafa.

Vetëvendosja e thërret Hotin në tri interpelanca: Për Ujmanin, të pagjeturit dhe asociacionin

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 TETOR - Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka dorëzuar tri kërkesa për interpelancë për kryeministrin Avdullah Hoti. Vetëvendosja ka sqaruar se kërkesa e parë lidhet me zotimin e Avdullah Hotit në Uashington për ta ndarë Liqenin e Ujmanit me Serbinë. “Kjo është e paprecedentë dhe e rrezikshme ngaqë e përparon interesin e Serbisë për ta minuar

soveranitetin e republikës sonë, duke i dhënë asaj qasje në resurse tona ekonomike dhe strategjike. As Hoti, po as delegacioni i tij nuk kanë legjitimitetin për ta bërë këtë”, thuhet në njoftimin e LV-së. Ndërkaq kërkesa e dytë ka të bëjë me zotimin tjetër të Hotit në Uashington që kushtëzon zbardhjen e fatit të të pagjeturve nga lufta e fundit me ata që janë zhvendosur. “Kjo përveçse është e dëmshme, është edhe çnjerëzore”, thuhet në këtë njoftim



Kurse interpelanca e tretë ka të bëjë me deklaratat e kryeministrin Hotit pas takimit me presidentin e Parlamentit

Evropian dhe Komisionin e Politikës së Jashtme ku tha se “do ta respektojë plotësisht marrëveshjen për ‘Zajednicën’.

“Kujtojmë që Gjykata Kushtetuese e kishte hedhur poshtë këtë plan të Serbisë, duke gjykuar se ajo shkel Kushtetutën e Republikës së Kosovës në gjithsej 23 pika. Në fund të interpelancës grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje do t’i propozojë Kuvendit të Republikës së Kosovës miratimin e një rezolute që, mes të tjerash, ia ndalon çdo zyrtari publik e shtetëror kompetencën dhe autorizimin për të biseduar për rikthimin e kësaj çështje”, thuhet në njoftimin e LV-së.

Synimet e Naser Sahitit në krye të Universitetit të Prishtinës

PRISHTINË, 11 TETOR - Përmirësimi i cilësisë së studimeve, rritja e kërkimeve shkencore, krijimi i infrastrukturës së mjaftueshme e ndërkombëtarizimi i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, janë disa nga synimet e rektorit të ri të UP-së, Naser Sahiti. Rektori i sapozgjedhur në krye të UP-së në një intervistë për “KosovaPress” ka folur për planet e veta në detyrën e re, sfidat dhe problemet në UP dhe zgjedhjen e prorektorëve. Organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor kur vendi po përballet me pandeminë Covid-19, rektori i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Naser Sahiti, e sheh si sfidën e parë me të cilën po përballet në detyrën e re. Megjithatë, ai thotë se deri më tani gjithçka është duke shkruar në rregull dhe se të gjitha orët e humbura për vitin e parë që ende nuk kanë filluar procesin mësimor do të zëvendësohen. “Deri më tani ka ekzistuar një vendim i senatit,

bazuar në të cilin mësimi është dashur të organizohet në mënyrë të kombinuar, pjesa teorike online, ndërsa pjesa laboratorike, klinike, ushtrimet në Fakultetin e Arteve me prani fizike të studentëve. Ndërsa nga mbledhja e fundit e senatit ne e kemi shtuar edhe një dispozitë në vendim brenda se cilës kemi lejuar që njësitë akademike aty ku e vlerësojnë se është e mundshme, të kenë mundësi ta organizojnë edhe pjesën teorike të mësimin me prani fizike të studentëve. Opsioni më i mirë është nëse kushtet ekzistojnë, nëse ekziston siguri që nuk do të rrezikohet shëndeti i studentëve dhe stafit akademik, nëse përfillen të gjithë rekomandimet e IKShPK-së atëherë opsioni më i mirë definitivisht është me prani fizike të studentëve”, ka pohuar ai. Prioritete të punës së tij, rektori thotë se e ka ngritjen e cilësisë së studimeve në Universitetin e Prishtinës, kurse tregon se si do ta arrijë një gjë të tillë.



“Mundësitë për veprimet që ndikojnë në përmirësim të cilësisë janë të shumta për shkak të natyrës komplekse të vet procesit mësimor. Disa prej atyre mundësive janë, për shembull, rritja e pjesëmarrjes së studentëve nëpër punë praktike në institucione, në kompani private, ato ndikojnë drejtpërdrejt në ngritje të

cilësisë së studimeve. Pastaj mundësi tjetër është përmirësimi i procesit të mësimdhënies nga ana e stafit akademik, mundësi tjetër është riformimi i kurrikulave ekzistuese në mënyrë që ato ta reflektojnë gjendjen në terren, në mënyrë që ato t’i kenë parasysh kërkesat e tregut. Këto janë disa prej atyre që mund të

ndërmerren. Sigurisht ka edhe të tjera që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë. Të gjitha këto janë në programin tim të rektorit dhe të cilat unë do t’i adresoj brenda mandatit tim, ashtu që brenda kësaj periudhe të shënojme një përparim në ngritjen e cilësisë së studimeve”, ka deklaruar rektori Sahiti.

PDK-ja: Mungesa e investimeve në çerdhe dhe shkolla rëndoi jetën e prindërve në Prishtinë

Blerand Stavileci nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka thënë të dielën se qeveritë e deritanishme të kryeqytetit, Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, janë shndërruar në pengesën kryesore të arsimit. “Si pasojë e mungesës së vizionit dhe mosmenaxhimit dhe realizimit efikas të buxhetit, arsimit po degradohet dhe është shndërruar në brengën kryesore të familjeve tona. Pasiguri e dilema të shumta nga cilësia e mësimi e deri te siguria fizike e fëmijëve tanë po e përcjellin secilën familje prishtinase”, ka thënë Stavileci



EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 TETOR - Zyrtarë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kanë mbajtur konferencë për media në të cilën kanë folur për mungesën shumëvjeçare të investimeve në çerdhe dhe shkolla në Prishtinë nga qeverisjet e deritanishme të kryeqytetit.

Blerand Stavileci ka thënë se arsimit i degraduar në vazhdimësi është shndërruar në brengën kryesore të familjeve tona. “Si pasojë e mungesës së vizionit dhe mosmenaxhimit të realizimit efikas të buxhetit, arsimit po degradohet dhe është shndërruar në brengën kryesore të familjeve tona. Pasiguri e dilema të shumta nga cilësia e mësimi e deri te siguria fizike e fëmijëve tanë po e

përcjellin secilën familje prishtinase”, ka thënë ai.

Po ashtu, Stavileci ka thënë se qeveritë e deritanishme të kryeqytetit, Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, janë shndërruar në pengesën kryesore të arsimit. “Qeverisjet lokale të dy partive në pushtet, partisë Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike, jo vetëm që nuk po kanë vizion, dije, guxim e energji për t’i çuar proceset përpara dhe për ta përmirësuar arsimin, por ato janë shndërruar në pengesën kryesore të kësaj fushe, duke e degraduar në të gjitha format dhe nivelet, me çka po rrezikohet e ardhmja e fëmijëve tanë. Tërësisht e pakuptueshme dhe e pajustificueshme që të kemi gjithë këto nevoja për investime e komunës t’i teprojnë nga 20

milione euro në vit, ndërkaq qeveria ta shkurtojë për 12 miliona euro buxhetin për arsim”, ka thënë Stavileci.

Ndërkaq deputetja nga e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, ka folur rreth politizimit të institucioneve arsimore në Komunën e Prishtinës, për vonesën në organizimin dhe përgatitjen e objekteve shkollore, për menaxhimin e dobët dhe për mungesën e ndarjes së fondeve për përballje me pandeminë Covid-19.

Deputetja Musliu-Shoshi ka potencuar se përzgjedhja e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave

po bëhet në kundërshtim me ligjin duke mos u respektuar parimi i meritokracisë, duke i nënshtruar të barabartë në konkurse. “Problem është edhe mospërzgjedhja e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve me konkurs nëpër shkolla, por vazhdojnë vetëm me emërimet që disa vite, dhe kjo është në shpërputhje me ligjin”, ka thënë ajo.

Deputetja Musliu-Shoshi ka shtuar se qeverisjet e deritanishme lokale nuk kanë bërë asgjë për mbështetje të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe barrën e madhe që kanë këto familje për shkollimin dhe

mbështetjen ndaj tyre. “Kemi drejtorë të cilët nuk i pranojnë fare në shkollë dhe kemi një sistem në komunën e Prishtinës që, përkundër financimit që merr nga ministria për të siguruar nga një asistent për këta fëmijë në shkollë, ata nuk e bëjnë dhe, aq më keq, nuk e dimë se për çka shpenzohen këto fonde. Janë familjet që vazhdojnë ta paguajnë asistencën për fëmijët. Shtoi këtu edhe shpenzimet e tjera që kanë për shëndetin e tyre. Këta fëmijë janë pjesë e çmuar e shoqërisë sonë dhe meritojnë të trajtohen me dinjitet, përkushtim dhe respekt nga komuna dhe shteti”, ka deklaruar Musliu-Shoshi.

Avokati Berisha: Në gjykatë dorëzuar prova për pafajësinë e Haki Rugovës

EPOKA
ERE

Q. RAMA

PEJË, 11 TETOR - Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, i arrestuar dy ditë më parë nën dyshimin për kryerje të veprës penale keqpërdorim i pozitës zyrtare, konflikt interesi dhe falsifikim i dokumentit, është paraqitur të dielën në një seancë dëgjimore në Gjykatën Themelore në Pejë. Në këtë seancë, Prokuroria Themelore në Pejë propozoi masën e arrestit shtëpiak ndaj Rugovës.

Besnik Berisha, avokat i kryetarit Rugova, pas përfundimit të kësaj seance ka thënë para gazetarëve, se në këtë seancë kanë dorëzuar prova të cilat tregojnë pafajësinë e kryetarit të Komunës së Istogut. “Kemi dorëzuar prova për secilin pretendim, kemi dorëzuar prova që nuk bëhet fjalë për falsifikim, kemi dorëzuar prova që nuk bëhet fjalë për shpronësim të

kundërligjshëm dhe prova të tjera”, është shprehur Berisha, duke shtuar se gjykata është duke trajtuar pretendimet e paraqitura dhe ende nuk dihet se çfarë mase do të vendoset për kryetarit Rugova.

Ai e ka akuzuar prokurorinë për fakte të falsifikuara. “Lajmi i parë është se zotëri Rugova shkon në shtëpi dhe një fjali që gjithë procedurës e kam shqiptuar është se, krim nuk ka bërë Haki, por Prokuroria. Po e nënvizoj, krimi nuk është bërë nga zotëri Haki Rugova, por arrestimi i tij është krejtësisht i kundërligjshëm, arbitrar dhe i motivuar për gjithçka tjetër, përveç për shkaqe ligjore. Prokuroria në momentin kur i ka dorëzuar dokumentet e tyre të cilat përmbanin fakte të falsifikuara, e nënvizoj, fakte të falsifikuara, ata e kanë ulur kokën dhe janë në pritje të një vendimi, po të ketë drejtësi, zotëri Rugova



do të kthehet në shtëpi, kthehet te qytetarët e tij që do t’u shërbejë me ndershmëri”, ka thënë avokati Berisha.

Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, ishte arrestuar të premten me urdhër të Prokurorisë Themelore në Pejë.

Haki Rugova është edhe nënkryetar i partisë në pushtet, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

426 milionë euro për hekurudhën Maqedonia e Veriut - Shqipëri

Shkup, 11 tetor - Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka deklaruar së fundmi se do të kërkojë 426 milionë euro (498 milionë dollarë) financim për ndërtimin e një linje hekurudhore që do ta lidhë qytetin e Kërçovës me kufirin me Shqipërinë. Qeveria ka autorizuar Ministrinë e Financave të nisë një thirrje për shprehje interesi nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe kreditorët dypalësh për të siguruar fonde, si dhe grante për sigurimin e ndihmës teknike për projektin. Projekti do të kryhet në dy faza, me fazën e parë që parashikon ndërtimin e pjesës hekurudhore Kërçovë - Strugë. Lidhja hekurudhore, pjesë e korridorit 8 të transportit evropian që kalon nga lindja në perëndim përmes Evropës Juglindore, është planifikuar të kalojë përmes Kërçovës dhe Strugës në Maqedoninë Veri-Perëndimore në fshatin Lin në Shqipëri. Në vitin 2018 ndërmarrja publike "Transporti hekurudhor i Maqedonisë" ka njoftuar se



seksioni hekurudhor pritej të ishte plotësisht funksional deri në 2023, shkruan "Scantv". Ndërtimi i pjesëve të korridorit 8 është duke u zbatuar në një

memorandum bashkëpunimi të nënshkruar nga ndërmarrjet hekurudhore maqedonase dhe shqiptare, duke synuar koordinimin e përpjekjeve për

paraqitjen e projekteve të përbashkëta institucioneve financiare ndërkombëtare në kërkimin e financimit. Korridorit 8 është një nga rrugët panevropiane

të transportit tokësor që shkon nga Durrësi në Shqipëri, nëpër Maqedoninë e Veriut për në qytetin e Varna, në bregdetin Bullgar të Detit të Zi.

Pandemia nuk i pengoi projektet e "Termokos"-it



PRISHTINË, 11 TETOR - Kryeshefi ekzekutiv i ngrohtores së qytetit "Termokos", Arsim Fetahu, ka thënë se edhe këtë vit kanë bërë shumë investime në aspektin e rehabilitimit dhe zgjerimit të rrjetit. Ai ka bërë me dije se vitin e kaluar është realizuar pjesa e parë e projektit të Komisionit Evropian në vlerë prej 8.8 milionë. "Po sikurse në vitet e kaluara edhe këtë vit ka shumë investime në aspektin e rehabilitimit dhe zgjerimit të rrjetit. Siç e dini, vitin e kaluar është realizuar pjesa e parë e projektit të Komisionit Evropian

në vlerë prej 8.8 milionë eurosh, ku një pjesë e madhe e lagjes 'Kalabria' dhe disa objekte publike si çerdhe dhe shkolla janë kyçë në qytetin e Prishtinës dhe e njëjta ka vazhduar edhe në këtë vit. Këtë vit janë kyçë për herë të parë shkolla 'Meto Bajraktari', çerdhja 'Xixëllonja', objekti i Ministrisë së Kulturës dhe Teatri Kombëtar dhe pesë objekte në lagjen 'Ulpiana'. Gjithashtu, ky projekt do të vazhdojë edhe në pjesën e 'Matit 1', ka thënë Fetahu për "EO". Sipas tij, edhe përkundër sfidave dhe vështirësive që ka shkaktuar,

pandemia asnjë projekt nuk është ndaluar nga "Termokosi". Fetahu ka falënderuar MSS-në dhe qeverinë amerikane për fondin e ndarë për "Termokosin", i cili kap vlerën e 10 milionë dollarëve. "Me këtë projekt do të bëhet vendosja e matësve të mençur dhe radiatorëve që konsumatorët tanë tash e tutje do të paguajnë varësisht sa shpenzojnë energji që mundëson se ata duhet të vetëdijesohen të kursejnë energji dhe të kemi mundësi ta bëjmë zgjerimin e rrjetit të konsumatori", ka thënë ai.

Zeka: Kosova ka vend për ta rritur borxhin publik për t'i përkrahur ndërmarrjet e goditura nga pandemia

PRISHTINË, 11 TETOR - Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, ka thënë se Kosova ka një normë të ulët të borxhit publik. Në këtë drejtim, Zeka ka theksuar se ky është momenti për ta tejkaluar situatën e krijuar nga pandemia. Ai ka thënë se Kosova duhet ta rrisë borxhin publik dhe t'i përkrahë ndërmarrjet e goditura, në mënyrë që të investohet në projektet infrastrukturore dhe të krijohen vende të reja të punës.

Zeka në një intervistë për "EO" ka thënë se ndërmarrjet publike janë në vështirësi të mëdha financiare sepse janë shfrytëzuar nga të gjitha partitë politike për punësimin e njerëzve, duke tejkaluar edhe nevojat e ndërmarrjeve të tilla sa i përket kapitalit njerëzor. "Duhet të shfrytëzohet tashmë në këtë fazë të rimëkëmbjes. Realisht Kosova ka një normë të ulët të borxhit publik dhe ky është çasti që kur duhet ta rrisim borxhin t'i përkrahim

ndërmarrjet dhe vendet e goditura dhe të investohet paralelisht në projektet infrastrukturore të natyrës strategjike", është shprehur Zeka. Ai ka thënë se synimi i qeverisë është që përmes Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike të ndryshohen një sërë ligjesh të cilat pritet të jenë në fuqi deri në fund të vitit 2021. Zeka ka theksuar se shpreson se gjatë vitit 2021 të ketë rritje ekonomike deri në 4 për qind.



Lufta politike po 'vret' bizneset

Përfaqësuesit e bizneseve kanë vlerësuar se mosmiratimi i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike është duke vështirësuar aktivitetin e tyre. Ata kanë theksuar se me miratimin dhe zbatimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike qeveria do të arrijë t'i subvencionojë pagat e punëtorëve në mënyrë që ta lehtësojë gjendjen financiare të bizneseve private

PRISHTINË, 11 TETOR - Vonesa e miratimit të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike është duke vështirësuar aktivitetin e bizneseve private, ka thënë Shpejtim Kuqi, drejtor i kompanisë "Solid", sipas të cilit, bizneset po punojnë me humbje. Ky projektligj, pas gjashtë dështimeve, do të paraqitet të hënën, më 12 shtator, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, për t'u votuar në lexim të parë. Bizneset private disa herë kanë shprehur shqetësimin se janë grumbulluar problemet e shkaktuara nga kriza e pandemisë me koronavirus, duke vënë në rrezik mbijetesën e tyre. Një nga bizneset që pret ndihmë nga qeveria pas miratimit të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, është kompania për prodhimin e këpucëve "Solid" në Suharekë. Kjo kompani, përveç tregut vendor, gjendet edhe në tregjet e Francës, Gjermanisë, Greqisë, Italisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, por edhe në Afrikë. Drejtori ekzekutiv në këtë fabrikë, Shpejtim Kuqi, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se institucionet shtetërore nuk po i kushtojnë vëmendje sektorit privat, konkretisht industrisë prodhuese. Ai ka treguar se aktualisht në kompani punojnë rreth 300 punëtorë, kurse shitja dhe eksporti ka rënë deri në 30 për qind. Kjo rënie ka ndikuar në të hyrat financiare, rrjedhimisht ka vështirësi për prodhim. "Numrin e punëtorëve jemi duke e mbajtur të njëjtë, jemi duke e mbajtur me forcat tona, jo që kemi punë për të gjithë, po

mundohemi që mos të largojmë punëtorë nga punë. Thjesht, jemi duke nxjerrë para nga xhepi dhe po fusim në biznes, luftë jemi duke bërë që mos të mos zvogëlojmë numrin e punëtorëve dhe të mbajmë gjallë industrinë. Duke shpresuar gjithmonë se shteti i kthen sytë nga sektori privat", ka thënë Kuqi. Ai ka shtuar se shpreson se me miratimin dhe zbatimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike qeveria do të arrijë t'i subvencionojë pagat e punëtorëve në mënyrë që ta lehtësojë gjendjen financiare të kompanisë. "Ne presim që qeveria për tre muaj t'i mbulojë shpenzimet e kompanisë për paga dhe kontribute të punëtorëve në mënyrë që mos ta ndalim prodhimin. Në muajin mars-prill-maj kompania ka paguar të gjithë punëtorët dhe subvencionet e qeverisë nuk i kemi zbritur në paga të punëtorëve", ka thënë Kuqi. Gjatë muajve mars dhe prill, Qeveria e Kosovës, në bazë të Pakos Emergjente Fiskale, ka ndarë nga 170 euro në muaj për punëtorët në sektorin privat. Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike është dokumenti bazë përmes të cilit po synohet të mbështeten në mënyrë financiare bizneset private, pas humbjeve të shkaktuara nga pandemia me koronavirus. Ky projektligj kap vlerën e 385 milionë eurove. Partitë opozitare në Kuvendin e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës, nuk po e votojnë ligjin, me arsyetimin se



nuk përmbush kërkesat e bizneseve. Votimi i këtij projektligji, veç të tjerash, do t'u mundësonte qytetarëve kontributpagues të tërheqin 10 për qind të mjeteve nga llogaria e tyre në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, kurse qeverisë rreth 100 milionë euro nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Por, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) nuk e ka përkrahur iniciativën e Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e 10-përqindëshit të mjeteve nga Fondi i Kursimeve Pensionale, pasi kjo zvogëlon pensionet e ardhshme dhe kufizon madhësinë e tregut të brendshëm të kapitalit. Ndërsa ka arsyetuar fokusimin e një pjese të mjeteve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) te masat zbutëse dhe të rimëkëmbjes në buxhetin e vitit 2021. Por, subjektet ekonomike në Kosovë, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në Prishtinë, Aleanca Kosovare e Biznesit, Oda e Afarizmit dhe Klubi i Prodhuesve të Kosovës, disa herë kanë kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, që ta votojnë projektligjin në mënyrë që të rimëkëmben bizneset, pasi shumë nga to janë

në rrezik të shuarjes. Mosmiratimi i këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës po ndodh për shkak të inateve politike në mes të pozitës dhe opozitës, ka thënë Mejditi Bektashi, profesor në Universitetin e Prishtinës. Sipas tij, kjo luftë politike po shkatërron ekonominë dhe pasojat janë të pariparueshme. "Deputetët duhet t'i ndërpresin mosmarrëveshjet e tyre politike dhe të mendojnë seriozisht për mbijetesën e bizneseve dhe shtresave më të varfra të popullsisë. Sepse nëse vazhdon ky avaz, atëherë rënia ekonomike në Republikën e Kosovës do të jetë dy ose trefish më e lartë se në shtetet e tjera të rajonit. Kuvendi i Kosovës duhet të jetë në shërbim të aktualitetit dhe të shpëtimit të funksionimit të bizneseve. Përndryshe, lufta politike kundër ekonomisë do të jetë më shkatërrimtare se çdo tjetër presion", ka thënë Bektashi. Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar ka thënë se populli i Kosovës dhe ekonomia e saj janë goditur rëndë nga pandemia. Politikë fiskale dhe financiare kanë zbutur ndikimin e goditjes në ekonominë familjare dhe biznese, ndonëse mungesa e konsensusit politik deri më tani

ka parandaluar një reagim më të fortë të politikave. Kurse kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se të vetmit të paprekur nga kjo krizë në ekonomi janë ata (deputetët) në parlament që marrin vendime, ndërsa familjarët e tyre i kanë të punësuar në institucionet publike. Humbjet e deritashme në ekonominë e Kosovës të shkaktuara nga pandemia, sipas tij, janë një miliard euro, kurse deri në fund të vitit mund të humbin mbi 30 mijë vende pune, ka thënë Rukiqi. Në pamundësi të miratimit të Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, Qeveria e Kosovës në fund të muajit shtator ka ndarë 60 milionë euro, për t'i rikuperuar humbjet që kanë pësuar nga pandemia Covid-19, shumë kjo që ende nuk ka filluar të transferohet te kompanitë. Transferimi i këtyre mjeteve duhet të ndahet në mënyrë transparente, ka kërkuar Fondi Monetar Ndërkombëtar. Mjetet e planifikuara duhet të sigurojnë që të mbrohen vendet e punës në kompani. Sipas FMN-së, kriteret për kualifikim për këto mjete duhet të jenë të qarta dhe listat e përfutuesve duhet të bëhen publike.

Rreth 90 për qind e investimeve të huaja në Kosovë shkojnë në blerjen e banesave

PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Edhe ato pak investime të huaja që vijnë në Kosovë nuk shkojnë në sektorë që do të gjeneronin vende të reja pune. Rreth 90 për qind e investimeve të huaja në vitin 2019 kanë shkuar në sektorin e patundshmërive. Kryesisht investitorët janë nga diaspora që paratë e tyre janë duke i investuar në blerjen e banesave. Sipas raportit vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për vitin 2019, Investimet e Huaja Direkte (IHD) kanë arritur vlerën prej 271.8 milionë eurosh, që paraqet nivel pothuajse të

ngjashëm me vitin 2018 (272.1 milionë euro). "IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 20 milionë eurosh (8.8 milionë euro në vitin 2018). Rritje e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e patundshmërive, i cili përbën rreth 87.1 për qind në gjithsej IHD-të dhe sektorin e industrisë, i cili ka një pjesëmarrje prej 3.9-përqindësh në gjithsej IHD-ve. Në anën tjetër, sektorët që shënuan rënie ishin kryesisht sektori i ndërtimit dhe ai i tregtisë", është thënë në raportin e BQK-së.



Komuna e Skenderajt dhe 'Islamic Relief' përkrahin me mëshqerra barrëse 27 familje në nevojë

SKENDERAJ, 11 TETOR (ER) - Komuna e Skenderajt, përkatesisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në bashkëpunim me organizatën "Islamic Relief" kanë bërë shpërndarjen e mëshqerrave barrëse për 27 familje në nevojë si dhe familjeve me jetim nga kjo komunë. Gjatë shpërndarjes së këtyre mëshqerrave, i pranishëm te familjet nevojtare ishte edhe drejtori i Bujqësisë, Sokol Sallahu, i cili edhe shprehi falënderime për organizatën për përkrahjen e vazhdueshme që po i ofron qytetit të Skenderajt. Sallahu, po ashtu, uroi edhe fermerët përfitues, duke

shpresuar se përmes kësaj ndihme të dhënë ata do të arrijnë që t'i rrisin përfitimet e tyre. "Në emër të komunës falënderoj organizatën 'Islamic Relief' për ndihmën që po na dhuron në vazhdimësi, po ashtu i uroj edhe përfituesit, duke shpresuar se kjo ndihmë ka për t'i ndihmuar që të arrijnë përfitime më të mëdha prej tyre në të ardhmen", ka thënë drejtori Sallahu. Edhe familjet të cilat janë bërë me mëshqerra barrëse, kanë falënderuar Komunën e Skenderajt, organizatën "Islamic Relief" si dhe kryetarin Bekim Jashari për ndihmën që po u ofrohen atyre për përmirësimin e gjendjes ekonomike.



Fermerët ferizajas trajnohen për ngritjen e pemishteve me arra



FERIZAJ, 11 TETOR (ER) - Në kuadër të projektit "Ngritja e pemishteve me arra" të financuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Ferizaj, me qëllim që në thirrjen publike, fermerët të kenë informacionin e dijet e nevojshme, është mbajtur trajnimi me temën "Ngritja e pemishteve të reja me arra

dhe masat e nevojshme agroteknike", ku para fermerëve ferizajas ka ligjruar profesori i pemëtarisë, Gjokë Duhanaj. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, bartëse e këtij projekti dhe drejtori i saj, Burim Bajrami, ka thënë se me këtë thirrje publike do të ngrehen 18 hektarë pemishte, ku do të përfitojnë 38 fermerë.

Ai ka thënë se forma e tillë e trajnimeve do të ndikojë jo vetëm në ngritjen e dijenive të fermerëve për ngritjen e pemishteve, por paraqet edhe investim afatgjatë në këtë drejtim. Trajnimi i organizuar në koordinim me GLV "Bifurkacioni" Ferizaj është ndjekur nga 50 fermerë ferizajas.

Fillon asfaltimi i rrugës Moronicë-Gjocaj-Jasiq

JUNIK, 11 TETOR (ER) - Ka filluar asfaltimi i rrugës që lidh Junikun me fshatrat Jasiq-Gjocaj, aneksi rrugor përmes parkut Moronica, projekt që ofron infrastrukturë të mirë rrugore dhe qasje të lehtë për qytetarët e fshatrave Gjocaj, Jasiq dhe për ata qytetarë të Junikut që gëzojnë parcela në këtë zonë. Projekti rrugor Moronicë-Gjocaj-Jasiq financohet nga fondet e grantit të

performancës së mirë komunale për vitin 2020. Ky grant bashkëfinancohet nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL) dhe donatorët mbështetës të qeverisë zvicerane, suedeze dhe norvegjeze, përfituese e të cilit grant është Komuna e Junikut. Projekti realizohet në kuadër të iniciativës "Shërbime të mira për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik".



Kastrati inspektoi punimet për rregullimin e përroit të Rubocit në Kamenicë


KAMENICË, 11 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me shefin e kabinetit, Meriton Ramabaja, kanë vizituar punimet për rregullimin e përroit të Rubocit. Kastrati ka thënë se rregullimi i këtij përroi është shumë i rëndësishëm sepse, përveç pamjes së bukur që do t'i ofrojë qytetit, ai mund të shfrytëzohet edhe për rekreacion nga

qytetarët e Kamenicës. "Trekëndëshi bulevard, shkollë e përroi i Rubocit. Afër bulevardit të qytetit dhe shkollës 'Fan S. Noli', e cila do të ndërtohet së shpejti, edhe projekti për rregullimin e shtratit të përroit të Rubocit është duke vazhduar sipas planit dinamik. Përpos ambientit fantastik që ka Kamenica, kjo hapësirë atraktive do të jetë në funksion të qytetarëve për ecje, shteg për

biçikleta, ulëse të integruara brenda shtratit të përroit, si dhe ura që do t'i lidhë shkollat e mesme me filloren. Qeverisje fjalëpakë e punë shumë", ka thënë Kastrati. Projekti "Rregullimi i ambientit dhe rekreacionit në Kamenicë", që kap vlerën afër 106 mijë euro, është bërë në bashkëpunim me Komunën e Kamenicës dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.



Emergjencia elektorale e Amerikës



Nga Janusz BUGAJSKI

Më pak se një muaj nga zgjedhjet presidenciale, politika amerikane ka hyrë në 'tokë të pashkelur'. Pasiguria në rritje varet nga shëndeti i Donald Trumpit pas infektimit me Covid-19 dhe shtrimit fillestar në spital. Pyetje të rëndësishme ngrihen, gjithashtu, në lidhje me procedurat që do të ndiqen nëse ndonjë nga kandidatët presidencialë bëhet 'i paaftë'. Si Trump ashtu edhe kandidati demokrat Joe Biden janë në të shtatëdhjetat dhe do të jenë presidentët më të vjetër në detyrë të ShBA-së: Trump është 74 vjeç, Bideni 77 vjeç. Deri më tani Bideni nuk është infektuar nga virusi, pasi ai ndjek rreptësisht procedurat gjatë paraqitjeve të tij në publik. Në ndryshim të dukshëm, Trumpi dhe ndihmësit e tij kanë qenë moskokëçarës duke mos mbajtur maska dhe duke u mbledhur pranë njëri-tjetrit në hapësira të mbyllura. Për më tepër, duke pasur parasysh moshën dhe mbipeshën e Trumpit, infektimi mund të ndikojë duke penguar shërimin e tij të plotë. Infektimi dhe mungesa e gatishmërisë së Trumpit për ta zbuluar gjendjen e tij shëndetësore gjithashtu shpreh dukshëm paaftësinë e tij për t'i bërë ballë pandemisë. Mosrespektimi i rekomandimeve bazë të epidemiologëve është kthyer për të ndjekur personalisht atë dhe disa nga bashkëpunëtorët e tij në Shtëpinë e Bardhë. Kjo do të dëm-

tojë më tej perspektivën për rizgjedhjen e tij, pasi një shumicë e madhe e nënshtetasve besojnë se ai nuk ka bërë mjaftueshëm për ta kontrolluar (përhapjen) e virusit. Deri në ditën e zgjedhjeve numri i të vdekurve në ShBA (nga virusi) parashikohet të arrijë një çerek milioni.

Pas debatit të parë televiziv presidencial, sondazhet në të gjithë vendin tregojnë se Bideni zgjerohet epërsinë e tij ndaj Trumpit në 16 për qind. 57 për qind e votuesve të regjistruar mbështesin Bidenin dhe 41 për qind Trumpin. Në të gjitha pyetjet kritike, përfshirë kujdesin për shëndetin, pabarazinë racore, emërimet në Gjykatën e Lartë, krimin dhe sigurinë, e madje edhe në trajtimin e ekonomisë, Biden ka një avantazh të konsiderueshëm. Në mes të fushatës zgjedhore, një skenar i ri krize duket në horizont, në rast se shëndeti i Trumpit përkeqësohet dhe atij i duhet të shtrohet sërisht në spital. Nëse presidenti bëhet i paaftë fizikisht ose mendërisht, ai nuk mund të marrë pjesë në zgjedhje. Sipas

nenit 25 të Kushtetutës, do t'i takonte zëvendës-presidentit Mike Pence ta merrte detyrën e presidentit dhe të ishte kandidati në zgjedhjet e 3 nëntorit. Përndryshe, do të duhej të zgjidhej një tjetër republikan si kandidat me Pence si partner në kandidim. E kjo mund të provokojë trazira politike.

Republikanët mund të zëvendësojnë një kandidat të vdekur ose të paaftë, por kjo është problematike afër ditës së zgjedhjeve. Tashmë mbi 60 milionë vota u janë dërguar votuesve dhe mbi 4 milionë votues kanë votuar me postë. Në nenin 20 të Kushtetutës thuhet se mandati i presidentit dhe zëvendës-presidentit aktual përfundon në Ditën e Përrurimit (Inaguration Day) më 20 janar, pa asnjë dispozitë për ta zgatur atë. Do të ishte pothuajse e pamundur ndryshimi i fletëve të votimit pa shtyrë zgjedhjet dhe duke e filluar procesin e votimit nga fillimi. Vetë data e zgjedhjeve përcaktohet me ligjin federal dhe vetëm Kongresi mund ta zhvendosë atë një skenar shumë i vështirë.

Do të ishte fjala për një skenar edhe më turbullues, nëse Trumpi, në fakt, i fiton zgjedhjet, por vdes ose bëhet i paaftë midis ditës së zgjedhjeve dhe inaugurimit të tij. Kjo nuk ka ndodhur kurrë më parë, megjithëse ShBA-ja ka periudhën më të gjatë të tranzicionit në (krahasim me) çdo demokraci. Kushtetuta, si dhe ligjet zgjedhore federale dhe të shteteve, do të ndihmonin për t'i dhënë drejtë procesit. Por, pa një precedent, rezultati është i paparashikueshëm. Nëse kandidati fitues vdes para se Kolegji Zgjedhor të mblidhet për t'i dorëzuar votat e tyre të shteteve, zgjedhësve do t'i duhet të bien dakord për një kandidat zëvendësues të rekomanduar nga partia fituese. Por, nuk ka asnjë garanci se ata do të binin dakord mbi kë do ta zëvendësonte fituesin e vdekur. Neni 20 bën të qartë se nëse presidenti i rizgjedhur vdes, zëvendës-presidenti i zgjedhur do të betohet si president në fillim të mandatit të ri. Sidoqoftë, kandidati fitues nuk është zyrtarisht

presidenti i zgjedhur derisa një seancë e përbashkët e Kongresit t'i numërojë votat e Kolegjit Zgjedhor dhe ta deklarojë fitues. Kjo mund të ndodhë vetëm pasi Kongresi i ri të betohet më 3 janar. Vetë procesi mund të shkaktojë mosmarrëveshje dhe konflikte midis dy partive. Ekziston një kërcënim edhe më i madh për procesin kushtetues - reagimi i bazës fanatike të mbështetësve të Trumpit. Ata mund të refuzojnë ta pranojnë humbjen e Trumpit ose nuk do ta besojnë se Trumpi është bërë i paaftë pasi ka fituar zgjedhjet. Mediat dhe rrjetet sociale pro-Trump ka të ngjarë ta ndezin flakën e rezistencës duke fajësuar demokratët, liberalët, "shtetin e thellë" dhe "mediat e rreme" për organizimin e një grushti shteti ose të një rrëmbimi. Në atë pikë, perspektiva për konflikt civil të drejtpërdrejtë dhe dhunë do të përshkallëzohej në mënyrë dramatike.

(Marrë nga gazeta "Dita", Tiranë)



Hapja e negociatave për integrim e Serbisë së udhëhequr nga Aleksandër Vuçiqi - Goebbelsi i Ballkanit, kompromisi më i madh i BE-së



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Është bërë praktikë e patjetërsueshme në Serbi që çdoherë kur dështojnë përpjekjet serbe për ta ndarë Kosovën,

Aleksandër Vuçiqi del me deklaratë se "Serbia është gjithmonë e gatshme të negociojë për zgjidhje të ndryshme kompromisi me Kosovën, por duhet të jetë një kompromis pa ultimatum!"

Të struktur nën strategjinë e mohimit të gjenocidit dhe shmangien e përgjegjësive konkrete në krimin e gjenocidit, ish-ministri i propagandës serbe në kohën e kryerjes së gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës, dhe presidenti aktual i Serbisë, Aleksandër Vuçiq -

Goebbelsi i Ballkanit, harron se: - Nuk ka kompromis më të madh politik sesa hapja e negociatave për integrim në Bashkimin Evropian të një shteti që ka qenë i përfshirë në gjenocidet kundër popullit kroat dhe atij boshnjak dhe që ka kryer drejtpërdrejt gjenocid kundër popullit shqiptar në Kosovë.

- Nuk ka kompromis më të madh politik sesa hapja e negociatave në kohën kur Serbia udhëhiqet nga Aleksandër Vuçiqi, Ivica Daçiçi dhe pinjoll-

lët tjerë të Slobodan Millosheviqit që ishin të përfshirë në krimin e gjenocidit në Kosovë.

- Nuk ka kompromis më të madh politik sesa vazhdimi i bisedimeve për integrim e Serbisë në vlerat euroatlantike, ndërkohë që ky shtet vazhdon të fshehtë në territorin e vet varrezat masive me civilë shqiptarë; Për të drejtën ndërkombe-tare gjenocidi i kryer ndaj shqiptarëve nuk mund të ketë trajtim tjetër në krahasim me gjenocidet që janë kryer në të

kaluarën. Prandaj, pa bashkëpunimin e plotë të Serbisë për ndriçimin e fatit të 1 600 civilëve shqiptarë dhe nxjerrjes përpara përgjegjësive të atyre që janë përgjegjës për vrasjen e 1 392 fëmijëve, të 1 739 grave dhe mijëra civilëve të tjerë të moshave të ndryshme si dhe zbatimin e dhunës seksuale ndaj mbi 20 000 grave shqiptare, BE-ja dhe ShBA-ja duhet t'i ndërpresin të gjitha bisedimet që i hapin rrugën Serbisë për t'u integruar në institucionet e euroatlantike.

1 TETORIN 1997 NUK DUHET TA NDEROJNË VETËM ATA QË E ORGANIZUAN DHE E UDHËHOQËN



Ismet SYLEJMANI

Shkoi 1 Tetori i vitit 2020, dhe e nderuan 1 Tetorin e vitit 1997, kryesisht vetëm ata që e organizuan!

Ata që e sabotuan atëherë nuk dolën kundër nderimit e organizimit nderues tash, por as

ata që nuk e organizuan drejtëpërdrejtë atëherë, e të cilëve u sherbeu shumeeee në male e jashtë Kosovës....!

Nuk e nderuan aq shumë sa duhej dhe bënë fare pak, ndonëse kishte mundësi dhe hapsirë, pasi pas 23 viteve duhej të ishte ngjarje e madhe studentore, mediale, politike, shtetërore e kombëtare, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri, diasporë e kudo!

Luftëtari dhe studenti, UÇK-ja dhe UNIVERSITETI, në prag të fillimit masiv të luftës së armatosur çlirimtare të UÇK-së, ishin katër nga armët më të mëdha që dispononte populli shqiptar në luftën kundër Serbise pushtuese!

Viti 1997 ishte viti që paralajmëronte se do të vinin vite të mëdha të luftës për liri të popullit shqiptar të Kosovës!

Viti 1997 i demonstratës studentore në përkrahje e në mbështetje të UÇK-së ishte dhe mbetet viti me domethënës në historinë e popullit shqiptar!

1 Tetori i vitit 1997 është viti historik që shpërtheu frikën dhe mbolli lirinë e armatosur çlirimtare, për të cilën kishte kohë që kishte filluar të godiste pa mëshirshëm dhe të luftonte nëpër pjesë të ndryshme UÇK dalëzotsja e popullit shqiptar e me së shumti në truallin e larë me gjak të Drenicës heroike! Kryesia e Unionit të Studenteve të Universitetit të Prishtinës, Rektorati i Universitetit me Rektorin historik Prof. Dr. Ejup Statovci u bënë të famshmit, u bënë të mëdhenjtë, u bënë të admiruarit e popullit shqiptar, por edhe u bënë armiqtë, kundërshtarët, të urryerit e rregjimit pushtues serb dhe të përbuzurit e politikës ditore pacifiste!

1 Tetori legjendar i vitit 1997 në Prishtinë, ishte paralajmërimi final se lufta e armatosur çlirimtare e UÇK-së do të jetë jo luftë cubash e të paknaqurish, anarkistësh e terroristësh, jo luftë të frustruarisht për pushtet e për poste, por luftë e popullit shqiptar kundër ushtrisë, policisë e formacioneve para militare e pushtuese serbe!

Drejtuesit e gjallë të UUP-së, personalitete historike të Unionit në kohën e demonstratës së vitit 1997, jo vetëm duhet të nderohen e të respektohen shumë, ndaj Tyre duhet të marrë shteti në dorë nderimin për ATA, sepse Ata bashkë me studentët levizën të palevizshmën, u bënë UÇK-ja pa armë në qytet dhe aleatët, përkrahësit dhe furnizuesit me njerëz të UÇK-së në malet liridashëse!

Kosova duhet të ketë lagje, sheshe e rrugë, që nderojnë demonstratën legjendare të 1 Tetorit 1997!

Kosova duhet të ketë dekorata e mirënjohje, monumente e skalitje të ndryshme artistike në nderim të 1 Tetorit 1997!

Pas 1 Tetorit 1997, ndryshoi gjithëçka në Kosovë, ndryshoi dhe u fuqizua edhe UÇK!

Kosova duhet ta caktojë agjenden shtetërore në nderim të kësaj ngjarjeje historike, sepse ajo nuk ishte do si do, dhe jeiona e saj ishte me permasa të mëdha kombëtare e ndërkombëtare!

1 TETORIN 1997 NUK DUHET TA NDEROJNË VETËM ATA QË E ORGANIZUAN DHE E UDHËHOQËN

Prishtinë, 11 Tetor 2020!



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Haxhi Robin Krasniqi, kampion i botës në IBO dhe WBA



PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Haxhi Robin Krasniqi ka arritur ta mposhtë gjermanin Dominic Boesel për titullin e botës IBO dhe WBA. Boksieri ynë ka arritur ta mposhtë me nokaut Boeselin pas vetëm tre raundesh. Të dy raundet e para ishin të mira për Krasniqin, që tentonte ta sulmonte gjermanin. Aty ai dha disa goditje të mira, por që kulmi erdhi në raundin e tretë.

Fillimisht, pas dy goditjeve të bukura, ai e rrëzoi në nokdaun, ndërsa pasi u ngrit Boesel në këmbë, një kombin tjetër e rrëzoi përfundimisht në tokë gjermanin. Krasniqi bëhet shqiptari i parë kampioni i parë i botës.

Robin Krasniqi ka 51 fitore dhe 6 humbje, prej tyre 19 me nokaut. Boesel para këtij takimi kishte 30 fitore dhe vetëm një humbje, duke e pësuar tani të dytën në karrierë.

Pas meçit Krasniqi dha një deklaratë emocionuese, duke thënë se ka qarë dhe ka qeshur

gjatë këtyre viteve për ta arritur qëllimin e tij.

Boksieri shqiptar priti 15 vjet për ta bërë realitet ëndrrën e tij që të jetë kampion bote. "I uroj Dominicut rikthim të shpejtë. Jemi familje e madhe... Kjo luftë ka zgjatur 15 vjet. Kam pasur ulje dhe ngritje. Kam qarë, kam qeshur. Tani kam arritur t'i përmbush ëndrrat e mia", ka

deklaruar Krasniqi.

Ish-boksieri nga Kosova, Luan Krasniqi ka uruar bashkëvendësin e tij, Haxhi Robin Krasniqi, pas shpalljes së tij kampion i botës në boks. "Urime Robin Krasniqi për fitimin e titullit kampion bote. Një fitore spektakolare. Shumë pak e besuan që do ta arrish këtë. Ti mund të jesh shumë krenar për këtë", ka shkruar Luan Krasniqi.

Festë patriotike pas shpalljes kampion bote në boks, Haxhi Krasniqi këndon këngën "Besa-besë"

Haxhi Robin Krasniqi ka festuar titullin kampion bote në boks me këngë patriotike. Boksieri nga Kosova ka arritur ta mposhtë me nokaut pas vetëm tre raundesh Dominic Boesel. Festa e boksierit nga Juniku, por edhe e gjithë shqiptarëve ishte e madhe, pasi është hera e parë që kemi një kampion bote. Megjithatë, Haxhi Krasniqi nuk ka harruar asnjëherë rrënjët e tij dhe festa e pas meçit nuk kishte se si të mungonte me këngë patriotike. Në një video të publikuar në rrjetin social "Facebook", Krasniqi shihet teksa feston dhe këndon këngën e njohur "Besa-Besë".

SHKURT

Kosovare Asllani shkruan historinë me Real Madridin, bëhet shënuesja e parë për ekipin e femrave

Prishtinë, 11 tetor - Futbollistja nga Kosova, Kosovare Asllani, ka shënuar golin e parë në histori të ekipit të femrave të Real Madridit. Klubi i femrave të Real Madridit nga ky sezon ka filluar garat në elitë, pasi është ribashkuar dhe ka blerë të drejtat e klubit Tacon. Megjithatë, 'galaktiket' nuk e kanë nisur mirë sezonin 2020/21 në Primera Division pasi janë mposhtur thellë 0-4 nga Barcelona në ndeshjen e parë. Në ndeshjen e javës së dytë, ekipi i femrave të Los Blancos nuk ka mundur të shkojë më shumë se një barazim 1-1 në udhëtim te Valencia. Golashënuesja e parë në histori të klubit të femrave të Realit dhe e vetmja në këtë ndeshje ishte futbollistja nga Kosova, Kosovare Asllani. Asllani ishte e saktë në minutën e 22-të të ndeshjes, duke i dhënë epërsinë 0-1 Real Madridit, por që ekipi nuk mundi ta mbajë deri në fund. Valencia barazoi disa minuta më vonë për 1-1 dhe me këtë rezultat u mbyll ndeshja.

Liverpooli mbështet idenë e 18 skuadrave në Ligën Premierë

Londër, 11 tetor - Liverpooli e ka mbështetur idenë që nga edicioni 2021/22, Liga Premierë t'i ketë vetëm 18 skuadra pjesëmarrëse. Kjo ide është dhënë nga disa anëtarë të ligës angleze dhe atë e ka mbështetur edhe ish-shefi ekzekutiv i Ligës Premierë dhe i Liverpoolit, Rick Parry. Nëse Arsenali, Chelsea, Manchester United, Manchester City dhe Tottenham Hotspuri japin dritën e gjelbër, atëherë ky ndryshim mund të ndodhë. Kjo nuk do të jetë e vetmja gjë që do të ndryshohet, pasi ndryshime do të ketë edhe në rregullin financiar, kontratat, rregullat në klube dhe huazimet e lojtarëve. Liverpooli është e para skuadër e madhe që ka dhënë ndryshimin e këtyre rregullave, në mënyrë që të rikthehet normaliteti në futboll. Klubet në vitet e fundit janë duke shpenzuar pa masë dhe kjo ide është mirëpritur nga shumica e klubeve.

Ibrahimoviq rikthehet në stërvitje të Milanit pas daljes nga karantina

Milano, 11 tetor - Sulmuesi i Milanit, Zlatan Ibrahimoviq, është kthyer në stërvitje pasi i dha fund periudhës së tij të karantinës dy ditë më parë. Suedezi 39-vjeçar u kthye në Milanello këtë mëngjes për ta mbajtur seancën e tij të parë stërvitore pas më shumë se dy javësh. Mediumi "Gazzetta dello Sport" ka zbuluar se ai mori pjesë në seancën e mbajtur të dielën në mëngjes. Ibrahimoviqi doli pozitiv me koronavirus përpara raundit të tretë kualifikues të Ligës së Evropës dhe si pasojë ka humbur katër ndeshje të Milanit. Veterani e filloi sezonin me dy gola ndaj Bolognas në Serinë A, ndërsa Milani ka tri fitore nga tri ndeshjet e para të sezonit 2020-21, pas triumfit ndaj Crotone dhe Spezia. Më 17 tetor, Milani përballlet me Interin në San Siro dhe Zlatan pritet të jetë në dispozicion për Derby della Madonnina e parë të këtij sezoni.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Republika e Kosovës
Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Departamenti i Arsimit të Lartë si dhe Këshilli Shkencor i MASH në vazhden e aktiviteteve të tyre, bazuar në dispozitat e Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore nr.04/L-135, bazuar në planin e veprimit të Programit Kombëtar të Shkencës në lidhje me përkrahjen e studimeve të doktoraturës në 500 universitetet më të mira në botë, shpall:

KONKURS

(Për ndarjen e granteve (bursave) të doktoraturës)

Me të cilin ftohen studentët kosovarë që ndjekin studimet e doktoraturës në 500 universitetet më të mira në botë që të konkurrojnë për përfitim të një granti të doktoraturës në vlerë vjetore prej 7500 eurosh. Konkursi është publik dhe vlen për studentët shtetas të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh promovimin e barazisë gjinore, etnike, fetare dhe racore. Do të përkrahen studentët që nuk marrim bursë apo ndihmë financiare nga institucionet vendore apo ndërkombëtare, apo që në marrëveshje me institucionin ku punojnë (universitetin apo institutin) kanë marrëveshje për mungesë me pagesë për kohën e kryerjes së studimeve të doktoratës. Merren parasysh studentët që kanë përfitur ndonjë bursë apo lloj tjetër të financimit që mund të jetë i pjesshëm (që nuk i plotëson nevojat financiare për studime njëvjeçare sipas standardeve të vendeve ku është selia e universitetit). Studentët me bursa të plota nuk përkrahen. Për të konkurruar në konkurs, studentët e interesuar duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- CV (Biografia)
- Studenti të jetë shtetas i Republikës së Kosovës – dëshmi: letërnjoftimi ose pasaporta e Republikës së Kosovës.
- Vërtetimi nga institucioni kosovar ku studentin është i punësuar, nëse studentin është lëshuar me pagesë për kryerjen e studimeve ose jo.
- Vërtetimi nga universiteti ku studentin i vijon studimet apo është regjistruar (studentët që kanë fituar të drejtën për studime, por ende nuk i kanë regjistruar apo nuk i vijnë ato, nuk përkrahen) në studimet e doktoraturës.
- Vërtetimi nga universiteti mikpritës se kandidati nuk ka bursë nga ky universitet apo nuk merr pagesë tjetër si pjesë e ndonjë projekti hulumtues në atë universitet dhe vërtetimin se kandidati nuk pranon ndonjë mbështetje financiare të natyrës tjetër nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor (studentët me bursa jo të plota apo me mbështetje jo të plotë financiare mund të mbështeten, në raste të veçanta). Studentët që nuk janë fillestarë duhet të sjellin dëshmi lidhur me provimet e dhëna apo dokumente origjinale që dëshmojnë arritjen e kushteve specifike që kërkon universiteti i veçantë për kryerjen me sukses të pjesës së kaluar të studimeve (provimet, pjesëmarrja në projekte hulumtuese shkencore, pjesëmarrja në konferenca, botime etj. Kjo vërtetohet me një dokument origjinal të nënshkruar dhe të vëlosur nga autoritetet e universitetit).
- Deklaratën e noterizuar se studentin pas kryerjes së studimeve do të kthehet në Kosovë si dhe deklaratën nën betim, se studentin nuk merr bursë apo ndonjë ndihmë financiare tjetër.
- Një vërtetim zyrtar se universiteti është i ranguar ndër 500 më të mirët në botë.

Përparësi kanë studentët që studiojnë në universitetet e ranguar më së larti në rangimet ndërkombëtare të universiteteve dhe fusha e studimeve të tyre bën pjesë në 5 plus 1, prioritetet kombëtare në bazë të Planit Kombëtar të Shkencës.

- Nuk mbështeten studentët që tashmë kanë përfunduar ciklin e ligjëratave apo që janë para mbrojtjes së disertacionit.
- Dokumentet relevante duhet të jenë të përkthyer nga një përkthyes zyrtar.
- Do të merret parasysh rangimi i universiteteve nga **Lista e Shanghait**.
- Konkursi mbetet i hapur (nga data 12.10.2020 deri më 23.10.2020 nga dita e shpalljes në gazeta, në uebfaqen e MASH dhe mediat elektronike.
- Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arkivin e MASH.
- Informatat shtesë mund të merren tek zyrtari kontaktues në MASH znj. Yllza Memeti, në zyrën 302/ b. Email; Yllza.Memeti@rks-gov.net tel për kontakt : 038 211-867.
- Aplikimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur ku të jetë shkruar "Aplikimi për grantet e doktoraturës" dhe në adresën : Rr. "Agim Ramadani" p. n, 10000-Prishtinë, Kosovë.
- **Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.**



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Departamenti za visoko obrazovanje i nauku

Departamenti za visoko obrazovanje i nauku i Naučni savet MONT-a u nastavku svojih aktivnosti, na osnovu odredbi Zakona o naučnoistraživačkoj delatnosti br.04 / L-135, na osnovu akcionog plana Nacionalnog naučnog programa u vezi podrške doktorske studije na 500 najboljih univerziteta u svetu, objavljuje:

KONKURS


(Za dodelu grante (stipendije) za doktoraturu)

Sa kojim se pozivaju kosovski studenti da pohađaju doktorske studije na 500 najboljih univerziteta na svetu da konkurisu za dobijanje grante za doktoraturu u vrednosti od 7500 evra. Konkurs je javan i odnosi se na studente koji su državljani Republike Kosovo, uzimajući u obzir promociju rodne, etničke, verske i rasne ravnopravnosti. Biće podržani studenti koji ne primaju stipendije ili finansijsku pomoć od lokalne ili međunarodne institucije, ili u dogovoru sa institucijom u kojima rade (univerzitete ili institute) imaju sporazum o plaćenom odsustvu za vreme završavanja doktorskih studija. U obzir će biti uzeti studenti koji su dobili stipendiju ili drugu vrstu delimičnog finansiranja (a koje ne zadovoljava finansijske potrebe za jednogodišnje studije prema standardima zemalja u kojima se univerzitet nalazi). Studenti sa punom stipendijom neće biti podržani. Da bi konkurisali na konkursu, zainteresovani studenti moraju da ispune i ove posebne uslove:

- CV (biografija)
- Student da je državljanin Republike Kosovo - dokaz: lična karta ili pasoš Republike Kosovo.
- Potvrda kosovske institucije u kojoj je student zaposlen, dali je studentu odobreno plaćeno odsustvo za obavljanje studije ili ne.
- Potvrda univerziteta na kojem student pohađa studije ili je upisan (studenti koji su stekli pravo na studije, ali još nisu upisali ili ne pohađaju, neće biti podržani) na doktorskim studijama.
- Potvrda univerziteta domaćina da kandidat nema stipendiju sa ovog univerziteta ili ne prima još drugu uplatu kao deo nekog istraživačkog projekta na tom univerzitetu i potvrdu da kandidat ne dobija nikakvu finansijsku podršku druge prirode od bilo koje relevantne međunarodne ili domaće institucije (studenti sa nepotpunim stipendijama ili sa nepotpunom finansijskom podrškom, mogu biti podržani u posebni slučajevi). Studenti koji nisu početnici moraju dostaviti dokaza u vezi položene ispite ili original dokumenta kojima dokazuje ispunjavanje specifične uslove koje zahteva poseban o uspešnom završetku prethodni deo završene studije (ispiti, učešće u naučno istraživačkim projektima, učešće na konferencijama, objavljivanja itd. Ovo može biti potvrđeno originalnim dokumentom potpisani overen pečatom od strane univerzitetske vlasti).
- Izjava overena kod notera da će se student nakon završetka studije vratiti na Kosovo kao i izjava pod zakletvom, da student ne dobija stipendiju ili bilo koju drugu novčanu pomoć.
- Zvanična potvrda da je univerzitet rangiran među 500 najboljih na svetu.


Prednost imaju studenti koji studiraju na univerzitetima rangiranim što više na međunarodnim univerzitetskim rang listama.

- i njihova oblast je deo 5 plus 1, nacionalnih prioriteta u okviru Nacionalnog naučnog plana.
- Neće biti podržani studenti koji su već završili ciklus predavanja ili koji su pred odbrane disertacije.
- Relevantni dokumenti moraju biti prevedeni od strane zvaničnog prevodioca.
- Biće uzeto u obzir rangiranje univerziteta sa **Šangajske liste**.
- Konkurs ostaje otvoren (od 12.10.2020 do 23.10.2020 od dana objavljivanja u novinama, na web stranici MONT-a i elektronskim medijima.
- Kompletan dokumentacija se dostavlja u arhivu MONT-a.
- Dodatne informacije mogu se dobiti kod službenika za kontakt u MONT-u gđe. Illza Memeti, u kancelariji 302 / b. Email; Yllza.Memeti@rks-gov.net kontakt tele: 038 211-867.
- Aplikacije treba dostaviti u zatvorenoj kovrti sa natpisom „Aplikacija za doktorsko grante“ i na CD-u na adresu: Ul. Agim Ramadani b.b 10000 Priština, Kosovo
- **Nepotpuna Aplikacije neće biti razmatrana.**



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Namik Rexhepi shpall te pavlefshme 4 dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren

► Xhelal Thaqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Luan Elezkurtaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Emine Geshtenja shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Albana Badalli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur

► Munever Qafleshi shpall te pavlefshme 3 dëftesat, certifikatën dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Shenoll Temo shpall te pavlefshme 2 dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

